

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani, kryetare, mr.sc. Erdogan Haxhibeqiri dhe Isa Kelmendi, anëtarë, në çështjen juridike të paditësve: S. Z. dhe S. Z. nga ..., të cilët i përfaqëson Z. I., avokat nga ..., sipas autorizimit, kundër të paditurës: Komuna e Podujevës-Drejtoria për Urbanizëm, Shërbime Publike dhe Ambient, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur përkitazi me revizionin e të paditurës e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr.4019/2013 datë 19.10.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më 15 janar 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i bazuar revizioni i të paditurës Komuna e Podujevës- Drejtoria për Urbanizëm, Shërbime Publike dhe Ambient, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr.4019/2013 datë 19.10.2017.

A r s y e t i m i

Me pjesën e I të dispozitivit, të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr.4019/2013 datë 19.10.2017, pranohet pjesërisht ankesa e të paditurës komuna e Podujevës - Drejtoria për Urbanizëm, Shërbime Publike dhe Ambient, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore Prishtinë-Dega në Podujevë, C.nr. 138/2011 datë 27.8.2013, në pjesën e kërkesëpadisë, sa i përket dëmit jo material për dhimbje fizike, për frikën e përjetuar, për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe shëmtimit trupor dhe gjykohet si në vijim: detyrohet e paditura Komuna e Podujevës – Drejtoria për Urbanizëm, Shërbime Publike dhe Ambient, që paditëses S.Z., nga Podujeva, në emër të kompensimit të dëmit, në aksidentin e komunikacionit të datës 9.10.2004, për 60% të përgjegjësisë, t’ia paguajë shumat e specifikuara dhe atë: për dhimbjet e përjetuara fizike t’ia paguajë shumën prej 2.100 €, për frikën shumën prej 1.200 €, për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 4.500 € dhe për shëmtim trupor shumën prej 600 €, e në shumë të tërësishme prej 8.400 €, të paguajë kamatë të cilën e paguajnë bankat afariste në Kosovë, sikurse për mjetet e deponuara pa destinim të caktuar, për 1 (një) vit, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë 27.8.2013, e deri në pagesën

definitive, ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadisë për dhimbje fizike, frikën, për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe shëmtimin trupor, përtej shumës së gjykuar refuzohet si e pabazuar.

Me pjesën II të dispozitivit, refuzohet e pabazuar ankesa e të paditurës Komuna e Podujevës-Drejtoria për Urbanizëm, Shërbime Publike dhe Ambient, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë, C.nr.138/2011 datë 27.8.2013, në pjesën tjetër të kërkesëpadisë për shpenzimet e procedurës vërtetohet.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë revizion me kohë ka paraqitur e paditura për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që aktgjykimet e të dy gjykatave të prishen dhe çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur në bazë të dispozitës së nenit 215 të LPK-së, ka gjetur se:

Revizioni i të paditurës është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se aksidenti i komunikacionit rrugor ka ndodhur më datën 9.10.2004 në qytetin e Podujevës, në drejtim të fshatit Sveçël, në momentin kur paditësja S.Z., duke u kyçur në rrugën dytësore, sekondare e që nuk ka pasur dalje, pasi që e njëjta nuk ka pasur shenja paralajmërimit të trafikut me automjetin "... .." me targa ..., hedhur në rrugë nga rruga sekondare në magjistrale Prishtinë-Merdar nga një lartësi prej disa metrave, me ç'rast ka pësuar lëndime të konstatuar nga ekspertët mjekësor. Nga ekspertiza e komunikacionit rrugor e datës 25.5.2007 e punuar nga Ing. i dip. A. P., i cili ka dhënë sqarime në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 27.8.2014, vërtetohet se rruga ku ka ndodhur aksidenti është përgjegjësi e të paditurës sepse bie në territorin e saj e jo në përgjegjësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe se në momentin e aksidentit nuk kishte shenja sinjalizuese që kanë paralajmëruar rrezikun dhe si pasojë e mos vendosjes së shenjave, ka ardhur edhe deri te shkaktimi i aksidentit me ç'rast e paditura ka përgjegjësi primare ndërsa paditësja ka përgjegjësi sekondare për shkak të mospërshtatjes së shpejtësisë.

Ekspertët mjekësor Dr. B.B.-otoped-traumatolog dhe Dr. N. M.-psikiatër, që të dy të punësuar në QKUK, në Prishtinë, kanë konstatuar se paditësja si pasojë e aksidentit ka pësuar lëndime të rënda trupore dhe atë: thyerje kompresave të unazës lumbale L-1 dhe si pasojë e këtyre lëndimeve paditësja ka përjetuar dhimbje fizike, intensitetit të lartë, intensitetit të mesëm, gjatë qëndrimit në këmbë, qëndrimit ulur, përkuljes etj, paditësja po ashtu ka përjetuar frikë sekondare

e intensitetit të lartë dhe të ulët, po ashtu ka përjetuar zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor të shprehur në përqindje 25%, zvogëlimi i aftësisë punuese në përqindje në shkallë prej 50%, shëmtim trupor i shkallës së lehtë, ndihma dhe kujdesi i huaj ka qenë i domosdoshëm një muaj, ushqimi i përforcuar ka qenë i domosdoshëm për tre muaj dhe terapi fizikale ka qenë e domosdoshme në tri vitet e para pas aksidentit një muaj në ndonjë qendër rehabilituese.

Gjykata e shkallës së parë, duke u nisur nga gjendja faktike e vërtetuar, ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e bazuar, duke iu referuar provave materiale të theksuara më lartë e duke marrë për bazë përgjegjësinë e ndarë 70% me 30%, ku e paditura është detyruar ta kompensojë dëmin prej 70% të përgjegjësisë ndërsa e paditësja 30% të përgjegjësisë. Për lartësinë e kërkesëpadisë, gjykata vendosi duke marrë parasysh ndarjen e përgjegjësisë 70% me 30% në atë mënyrë që gjykata në emër të dëmit jo material për dhimbje fizike paditëses ia pranoi shumën prej 3.200 €, për frikën e përjetuar shumën prej 2.000 €, për shëmtim trupor shumën prej 700 €, për zvogëlimin e aftësisë së përgjithshme jetësore në shkallë prej 25% shumën prej 5.000 € apo shumën e tërësishme prej 8.300 €, ndërsa kërkesëpadinë e paditëses në pjesë tjera dhe përtej shumës së gjykuar e refuzoi si të pa bazuar. Sa i përket paditësit S. Z., i autorizuar i paditësve ka hequr dorë nga padia.

Gjykata e shkallës së dytë, në procedurën e ankimimit, ka pranuar pjesërisht ankesën e të paditurës duke u bazuar në mendimin dhe konstatimin e ekspertit dhe plotësimin dhe sqarimit të mendimit të tij, në seancën e shqyrtimit kryesor ka vlerësuar se në këtë rast përgjegjësia është e ndarë 60% për të paditurën dhe 40% për paditësen. Përgjegjësia për 60%, e të paditurës sipas vlerësimit të asaj gjykate konsiston në faktin se e paditura nuk ka vepruar dhe mirëmbajtur shenjat e komunikacionit vertikal dhe atyre horizontal mbrojtësve-pahive elastike me tabela reflektuese të ngjyrosura me ngjyra alternative me shirita të pjerrët reflektuese me ngjyrë të bardhë dhe portokall dhe vendosja e shenjës së ndalimit, qarkullimi në fund të segmentit të kësaj rruge sekondare pa dalje dhe e paditura ka pasur obligim vendosjen e këtyre shiritave sepse rruga ku ka ndodhur aksidenti, është në territorin e komunës së Podujevës dhe se e njëjta mban përgjegjësi për mirëmbajtjen e kësaj rruge dhe në bazë të këtyre rrethanave e paditura ka përgjegjësi primare në shkaktimin e këtij aksidenti. Përgjegjësia prej 40%, e paditëses konsiston në faktin se paditësja si ngasëse e automjetit "...", në momentin e aksidentit e ka drejtuar veturën duke mos iu përshtatur shpejtësisë dhe kushteve të rrugës dhe në bazë të këtyre rrethanave paditësja ka përgjegjësi sekondare në shkaktimin e këtij aksidenti në lartësi prej 40%. Andaj, duke u nisur nga shkalla e përgjegjësisë 60% në 40% paditëses në emër të kompensimit të dëmit jo material për 60% të përgjegjësisë, në emër të dhimbjeve të përjetuara fizike pranoi shumën

prej 2.100 €, për frikën shumë prej 1.200 €, për zvogëlimin e aktivitetit jetësor shumë prej 450 € dhe për shëmtim trupor shumë prej 600 €, e shumë e tërësishme prej 8.400 €, me kamatë si në dispozitiv të vendimit të asaj gjykate. Gjykata e shkallës së dytë në pjesën II të dispozitivit, ka refuzuar ankesën e të paditurës ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë përkitazi me shpenzimet e procedurës e ka vërtetuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes ka gjetur se gjykata e shkallës së dytë duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike drejt ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale përkitazi me përgjegjësinë e ndarë 60% të paditurës dhe 40% paditëses dhe mbi këtë bazë drejt ka vlerësuar se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e bazuar lidhur me të drejtën e saj për kompensimin e dëmit, për faktin se e paditura mban përgjegjësi primare për kompensimin e dëmit të cilën e ka pësuar paditësja si pasojë e mos mirëmbajtjes së rrugëve gjegjësisht për shkak të mungesës së shenjës lajmëruese apo murit ndalues duke u mbështetur në vlerësimin e ekspertit të komunikacionit dhe plotësisht e sqarimit të mendimit të tij, në seancën e shqyrtimit kryesor mbi këtë bazë drejt është vlerësuar baza juridike e kërkesëpadisë që e paditura të jetë përgjegjëse për të kompensuar dëmin paditëses në mbështetje të dispozitës së nenit 154, 158 dhe 178.1 të LMD.

Vlerësimi i shpërblimit për dëmin jo material përfaqëson zbatimin e të drejtës materiale. Gjatë caktimit të lartësisë së shpërblimit për format e caktuara të dëmit jo material, gjykata sipas nenit 200 të LMD-së, duhet të kujdeset për rëndësinë e të mirës së dëmtuar dhe qëllimit të cilit i shërben ai shpërblim, por edhe për çështjen që të mos favorizojnë synimet të cilat nuk janë në përputhje me natyrën e shpërblimit të tillë të dëmit jo material dhe qëllimin shoqëror. Duke pasur parasysh kriteret e parapara me këtë dispozitë, rëndësinë e vlerave të dëmtuara të paditëses, shkallën e intensitetit dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve fizike dhe frikës dhe, shkallën e shëmtimit sipas gjendjes së vërtetuar nga ana e ekspertëve siç u tha më sipër dhe rrethanat tjera, shumat e gjykuara nga gjykata e shkallës së dytë në emër të dëmit jo material përkitazi me dhimbjet e përjetuara fizike dhe frikën e përjetuar, kompensimin në emër të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, shëmtimin sipas vlerësimit të kësaj Gjykate janë reale, për arsye se këto forma të dëmit janë caktuar në harmoni me dispozitën e nenit 200 par. 1 dhe 2 të LMD, dhe një kohësishit janë ekuivalente me intensitetin e dhimbjeve dhe frikës, dhe i përgjigjen natyrës së lëndimeve që ka përjetuar paditësja, moshën e paditëses, si dhe rrethanave tjera që ndikojnë në lartësinë e kompensimit si dhe praktikën gjyqësore për gjykimin e këtyre formave të dëmit.

Nga arsyet e cekura, si dhe të dhënat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, kjo Gjykatë vlerëson si të pa bazuara thinjet në revizionin e së paditurës se aktgjykimet e të dy gjykatave janë marrë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, lidhur me shumat e gjuakuara të dëmit jo material.

Thëniet në revizion se aktgjykimet e të dy gjykatave, janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, kjo Gjykatë i vlerësoi dhe gjeti si të papranueshme, për faktin se e paditura në revizion nuk saktëson në kuptim të ligjit se ku konsistojnë shkeljet e pretenduara në revizion, ndërsa Gjykata e revizionit e shqyrton aktgjykimin e goditur, brenda kufijve të shkaqeve të treguara në revizion (neni 215 të LPK-së).

Thëniet tjera në revizion lidhur me përjashtimin e përgjegjësisë së paditurës për kompensimin e dëmit, vërejtjet lidhur me mendimin dhe konstatimin e ekspertit të mbrojtjes në punë, ekspertëve mjekësorë, kjo Gjykatë i vlerësoi si pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështjes juridike për faktin se, vërejtjet e tilla në këtë fazë të procedurës nuk paraqesin referenca ligjore për marrjen e vendimit më të favorshëm për të paditurën. E paditura në asnjë rrethanë edhe pse bara e provave për lirimin nga përgjegjësia bie mbi te nuk ka argumentuar pafajësinë e saj për pjesën e përgjegjësisë për kompensimin e dëmit, dhe për lëshimet e veta nuk mund të fajësoj gjykatën.

Nga sa u tha më sipër me zbatimin e dispozitës së nenit 222,të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Rev.nr.274/2017 datë 15 janar 2018

Kryetare e kolegjit,
Gyltene Sylejmani